



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 619, Prot.

Tiranë, më 31.12.2019

L ë n d a : *Kërkesë për ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore.*

Drejtuar: **Zonjës ETILDA GJONAJ,**
MINISTRE E DREJTËSISË

Për dijeni: **KËSHILLIT TË MINISTRAVE**
KUVENDIT TË SHQIPËRISË
KOMISIONIT TË LIGJEVE
MISIONIT EURALIUS
PROJEKTIT TË USAID-IT "DREJTËSI PËR TË
GJITHË"

E nderuara Zonja Ministre,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit qeverisës të sistemit gjyqësor, i ngarkuar nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me funksionin ligjor të dhënies së opinioneve mbi legjislacionin, që mund të ndikojnë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e tij, marrë shkas nga gjendja aktuale e sistemit gjyqësor, veçanërisht në gjykatat e apeleve, konsideron t'Ju kërkojë ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në funksion të adresimit të disa problematikave të lindura gjatë zbatimit të Reformës në Drejtësi.

Problematika më të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor po ndeshet në vijimësi, por që aktualisht është bërë tepër shqetësuese, lidhet me administrimin e gjykatave të apelit, kjo sa i përket numrit të gjyqtarëve në këto gjykata, në funksion të menaxhimit efikas të ngarkesës gjyqësore dhe cilësisë së produktivitetit të tyre.

Në informojmë se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në gjykatat e apelit, qoftë në ato me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe në ato me juridiksion të posaçëm (atë administrativ dhe atë për korrupsionin dhe krimin e organizuar), ndërsa ende nuk ka përfunduar procesi i riorganizimit të treteve gjyqësore dhe përcaktimi i kompetencave tokësore të gjykatave, vijon të jetë siç përcaktohej nga legjislacioni në fuqi në momentin e miratimit të paketës ligjore për Reformën në Drejtësi, ndër to edhe të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht, bazuar në dekretet përkatëse të Presidentit të Republikës për organikat e gjyqtarëve të gjykatave të apelit, numri total i tyre është 102 (njëqind e dy), nga të cilët 24 (njëzet e katër) është numri i gjyqtarëve në gjykatat e posaçme (trembëdhjetë gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe njëmbëdhjetë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda/sot Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar).

Në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve sipas Ligjit nr.84/2016, pra në Tetor 2017, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në detyrë në gjykatat e apelit ka qenë 99 (nëntëdhjetë e nëntë), ndërsa ka patur 3 (tre) pozicione të lira të përhershme në dy gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm (dy në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe një në Gjykatën e Apelit Vlorë).

Aktualisht, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në detyrë në gjykatat e apelit është 63 (gjashtëdhjetë e tre), ndërsa në Janar 2020 ky numër do të jetë 61 (gjashtëdhjetë e një), pasi Këshilli do të duhet të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për 2 (dy) gjyqtarë, të cilët në Dhjetor 2019 kanë dhënë dorëheqjen nga detyra. Pra, gjatë periudhës së zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar në gjykatat e apelit janë krijuar edhe 38 (tridhjetë tetë) pozicione të lira, që bashkë me 3 (tre) pozicionet që kanë qenë të lira në momentin e fillimit të procesit, në total bëjnë 41 (pozicione të lira).

Nga pozicionet e lira, 21 (njëzet e një) prej tyre janë të përhershme, nga të cilat 18 (tetëmbëdhjetë) janë krijuar pas fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, ku 7 (shtatë) prej tyre janë krijuar për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve, 6 (gjashtë) të tjera për shkak të dorëheqjes së gjyqtarëve, 4 (katër) të tjera për shkak të mbushjes nga gjyqtarët të moshës së pensionit dhe 1 (një) tjetër për shkak të dënimit penal të gjyqtarit. Këto pozicione të lira të përhershme, sipas Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mund të plotësohen përmes tre mekanizmave që ky ligj parashikon, konkretisht përmes ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele dhe/ose transferimit të përkohshëm (me ose pa pëlqim).

Kurse 20 (njëzet) pozicionet e tjera të lira, janë të përkohshme. Nga këto, 14 (katërmëdhjetë) pozicione janë krijuar nga pezullimi *ex lege* i gjyqtarëve sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, 2 (dy) të tjera nga pezullimi i gjyqtarëve për shkak të ushtrimit ndaj tyre të ndjekjes penale, 2 (dy) të tjera për shkak të zgjedhjes së gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe 2 (dy) të tjera nga dhënia e lejeve afatgjata dyvjeçare

për gjyqtarët nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, leje këto që përfundojnë në Prill 2020 dhe në Tetor 2020. Nga këto pozicione të lira të përkohshme, vetëm 6 (gjashtë) prej tyre, sipas Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mund të plotësohen përmes dy mekanizmave që ky ligj parashikon, konkretisht përmes lëvizjes paralele dhe ose transferimit të përkohshëm (me ose pa pëlqim).

Referuar të dhënave si më lart, rezultojnë aktualisht gjykatat e apelit funksionojnë me një numër të reduktuar gjyqtarësh, me rreth 40% më pak se numri i përgjithshëm i përcaktuar për ato, numër ky që referuar objektivave, parimeve dhe kritereve të parashikuara në nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, por edhe standardeve të vendosura nga Komisioni Europian për Efikasitetin në Drejtësi në Këshillin e Europës (CEPEJ), do të duhet të rivlerësohet me qëllim rritjen e tij, në funksionin të përmirësimit të efikasitetit të gjykatave dhe të gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë.

Ndërkohë, numri i gjyqtarëve të gjykatave të apelit është e pritshme të reduktohet akoma më tepër si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar, nisur kjo nga deklarimi publik i disa kohëve më parë të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për rezultatet negative të kontrollit të pasurisë dhe interesave privatë për rreth 50% të gjyqtarëve të gjykatave të apelit, si dhe nga trendi i rezultateve të procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërkohë që prej disa muajve të gjithë gjyqtarët e këtyre gjykatave janë në proces rivlerësimi kalimtar dhe pritet përfundimi i këtij procesi përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira, të përhershme ose të përkohshme, në gjykatat e apelit, referuar mekanizmave të parashikuara nga Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mund të thuhet se ekzistojnë disa problematika.

Konkretisht, sa i përket mekanizmit të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të përhershme, zbatimi i tij kushtëzohet nga procesi i rivlerësimit kalimtar, ndërsa ligji, për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, si kriter, ndër të tjerë, ka përcaktuar edhe atë të kalimit me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, proces për të cilin, sa i përket gjyqtarëve që plotësojnë aktualisht kriterin e përvojës, merr përparësi kalimi nga ata të procesit të rivlerësimit kalimtar në kushtet kur këta gjyqtarë janë *ex officio* subjekte të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Aktualisht, numri i gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, pra numri i gjyqtarëve potencial që mund të kandidojnë për ngritjen në detyrë, është shumë i kufizuar, vetëm 15 (pesëmbëdhjetë). Nga këta, 10 (dhjetë) gjyqtarë janë të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku 3 (tre) prej të cilëve ushtrojnë funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe që për këtë shkak ata kanë pengesë ligjore për ngritjen në detyrë. Për 7 (shtatë) gjyqtarët e tjerë, për 2 (dy) nga ata, vendimi i konfirmimit në

detyrë nuk është përfundimtar (është paraqitur ankim nga Komisioneri Publik). Nga ana tjetër, 5 (pesë) gjyqtarët e tjerë të konfirmuar në detyrë janë të gjykatave administrative të shkallës së parë, ku për 1 (një) nga të cilët vendimi i konfirmimit në detyrë nuk është përfundimtar (është paraqitur ankim nga Komisioneri Publik).

Ndërkohë, sipas njoftimeve publike të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për 4 (katër) gjyqtarë njëherazi dhe kryetarë të gjykatave të shkallës së parë (tre gjyqtarë/kryetarë të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe një i gjykatave administrative), procesi i rivlerësimit kalimtar ka shumë muaj që ka nisur, por nuk ka përfunduar ende, ndërsa për 64 (gjashtëdhjetë e katër) gjyqtarë të tjerë të këtyre gjykatave (pesëdhjetë e nëntë gjyqtarë të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe pesë të gjykatave administrative) procesi i rivlerësimit kalimtar sapo ka filluar. Referuar historikut të kohëzgjatjes së procesve të mëparshme të rivlerësimeve kalimtare, të paktën për 64 (gjashtëdhjetë e katër) gjyqtarët për të cilët sapo ka filluar, procesi i rivlerësimit patjetër do të kërkojë disa muaj apo dhe vit.

Nga ana tjetër, gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë, me juridiksion të përgjithshëm apo administrativ, për të cilët ende nuk ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar, marrë shkas nga rezultatet e deritanishme të këtij procesi, mund të kenë një farë stepje për të kandiduar për ngritjen në detyrë, pasi kandidimi mund të passillte për ata fillimin, me prioritet, të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Përveç sa më lart, zbatimi i mekanizmit të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të përhershme kushtëzohet edhe nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, ndërsa ligji, për efekt të përzgjedhjes së kandidatit për ngritjen në detyrë, si kriter bazë ka përcaktuar rezultatet e dy vlerësimeve etike dhe profesionale të mëparshme, ndërkohë që aktualisht vlerësimet etike dhe profesionale të gjyqtarëve i përkasin një periudhe të përpara 10 viteve, që si të tilla nuk janë koherente, shkak për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar bërjen domosdoshmërisht të një vlerësimi të përsheptuar për çdo kandidat, që përfshin periudhën e fundit të punës. Por bërja e një vlerësimi të tillë, pavarësisht angazhimit të të gjithë aktorëve të këtij procesi, do të kërkojë patjetër kohën e nevojshme.

Pra, mund të thuhet se zbatimi i mekanizmit të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të përhershme, ndërsa është i kushtëzuar nga procese të tjera si më lart u përmend, nuk do të mund të adresojë në kohë plotësimin e vakancave të përhershme të krijuar në gjykatat e apelit.

Sa i përket mekanizmit të lëvizjes paralele për pozicionet e lira të përhershme dhe të përkohshme, zbatimi i tij kërkon ndjekjen e tre procedurave, fillimisht për ata gjyqtarë që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale, më pas, në rast se nuk ka kandidime nga kjo kategori gjyqtarësh hapet procedura për ata gjyqtarë që kanë një vlerësim etik dhe profesional dhe, më tej, nëse nuk ka kandidime edhe nga kjo kategori gjyqtarësh hapet procedura për ata gjyqtarë që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional. Pra, ndjekja e këtyre hapave/procedurave kërkon patjetër kohën e

vetë të nevojshme. Përtej kësaj, gati të gjithë gjyqtarët e gjykatave të apelit nuk kanë vlerësim etik dhe profesional për periudhën e fundit 10-vjeçare, çka bën jokohërente konsiderimin e vlerësimeve të tyre të fundit etike dhe profesionale, sikurse kërkohet nga ligji, ndërkohë që mospasja e vlerësimeve të tilla nuk i bën ata përgjegjës dhe për këtë shkak nuk mund të shërbejë si kriter përjashtues nga kandidimi, pra si masë penalizuese ndaj tyre.

Përveç sa më lart, zbatimi i mekanizmit të lëvizjes paralele nuk është efektiv në situatën aktuale përsa kohë çdo lëvizje paralele do të përkeqësonte akoma më tepër funksionalitetin e gjykatës/gjykatave nga ky gjyqtarët do të duhet të lëviznin, shtuar kësaj dhe situatën e paparashikueshme që mund të vijë nga përfundimi së afërmi i procesit të rivlerësimit kalimtar për të gjithë gjyqtarët në detyrë në gjykatat e apelit. Është e kuptueshme se interesi i gjyqtarëve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm është në drejtim të lëvizjes paralele në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jo e kundërta, ndërkohë që këto gjykata ose kanë dalë jashtë funksionit, ose funksionaliteti i tyre është çenuar rëndë. Ndërkohë edhe Gjykata e Apelit Tiranë aktualisht funksionon vetëm me 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarë, nga 31 (tridhjetë e një) që është numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të saj. Nga 14 (katëmbëdhjetë) pozicionet e lira në këtë gjykatë, 9 (nëntë) prej tyre janë të përhershme, kurse 5 (pesë) të tjerat janë të përkohshme, nga të cilat, si rregull, 2 (dy) pozicione plotësohen gjatë vitit 2020 (në Prill dhe në Tetor), me përfundimin e lejeve afatgjata të dhëna nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe kthimin në detyrë të dy gjyqtarëve.

Bëjmë me dije se në Gjykatën e Apelit Korçë ka vetëm 2 (dy) gjyqtarë në detyrë dhe që për këtë shkak ajo është jashtë funksionit, ndërsa nuk arrin dot, me këtë numër gjyqtarësh, të gjykojë asnjë çështje. Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë kanë në detyrë nga 5 (pesë) gjyqtarë, Gjykata e Apelit Shkodër ka në detyrë 6 (gjashtë) gjyqtarë, ndërsa Gjykata e Apelit Vlorë ka në detyrë 8 (tetë) gjyqtarë, duke bërë të pjesshëm funksionalitetin e tyre.

Pikërisht në kushtet e cenimit të funksionalitetit të gjykatave, në veçanti të gjykatave të apelit, përgjatë gjithë vitit 2019, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në këto gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në një akt normativ të miratuar prej tij (Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”), është detyruar të caktojë gjyqtarë nga gjykatat e tjera, çka sigurisht që ka shkaktuar problematika në efikasitetin e gjykatave dhe të gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë. Por, në kushtet e reduktimit domethënës të numrit të gjyqtarëve në detyrë në gjykatat e apelit, ndërsa numri i çështjeve gjyqësore, për gjykimin e të cilave nevojitet caktimi i gjyqtarëve nga gjykata të tjera, vijon të rritet në mënyrë eksponenciale, vijimi i zbatimit të këtij mekanizmi nga Këshilli do të denatyrizojë qëllimin e tij ose Këshilli do të duhet të konsiderojë kufizimin e zbatimit të tij, çka do të bënte akoma më të prekshme mungesën e funksionalitetit të këtyre gjykatave.

Lidhur me lëvizjen paralele në gjykatën e posaçme, atë të apelit administrativ, zbatimi i këtij mekanizmi paraqet edhe një problematikë tjetër për shkak të ligjit, ndërsa pika 9, e nenit 42, të

Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kufizon rrethin e kandidatëve duke përcaktuar se *“Në rast të hapjes së pozicioneve të lira në gjykatën e apelit administrativ, procedura e lëvizjeve paralele do të jetë e hapur vetëm për gjyqtarë që kanë punuar për të paktën për pesë vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet administrative”*. Kriteri i përvojës së veçantë - *de facto* bën të pamundur zbatimin e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërsa tashmë kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga momenti i krijimit dhe fillimit të funksionimit edhe të kësaj gjykate (data 04.11.2013), çka do të thotë se nuk ka asnjë gjyqtar të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm që të ketë të paktën për pesë vjet, në 9 vitet e fundit, si gjyqtar në çështjet administrative. Në rastin më të mirë, sot, kjo përvojë do të jetë më pak se 3 vjet.

Lidhur me lëvizjen paralele në gjykatën e posaçme, atë të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar, zbatimi i këtij mekanizmi është i pamundur nga ligji, pikërisht pika 8, e nenit 42, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit *“Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar”*.

Sa i përket mekanizmit të transferimit të përkohshëm (me ose pa pëlqim), për zbatimin e tij aktualisht në rastin e pozicioneve të lira në gjykatat e apelit, me përjashtim të procedurës, paraqet të njëjtat problematika si dhe mekanizmi i lëvizjes paralele.

Vlen të theksohet se plotësimi i pozicioneve të lira në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ndërsa mund të realizohet vetëm përmes mekanizmit të ngritjes në detyrë, tashmë me fillimin e funksionimit të këtyre gjykatave (më datë 19.12.2019), paraqet urgjencë të lartë në kushtet kur aktualisht, për gjykimin e disa çështjeve gjyqësore që ndodhen pranë tyre, duke aplikuar Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka caktuar gjyqtarë nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm, të cilët nga ana tjetër nuk përmbushin kushtet e sigurisë, të parashikuara në Ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, siç është dhënia e pëlqimit për rishikimin periodik të llogarive financiare dhe telekomunikimeve vetjake, për vete dhe për të afërmit e tyre.

Po për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, sa i përket pagave të gjyqtarëve, legjislacioni në fuqi nuk është i plotë dhe krijon vështirësi në zbatim. Konkretisht, sipas shkronjës “d”, të pikës 5, të nenit 12, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, *“Paga mujore bruto e magjistratit përbëhet nga elementet si vijon:...; d) shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*. Në Ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i vetmi rregullim që lidhet me pagën e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme

VEËTË DEKLARIM (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)", ku parashikohet se "Gjithashtu jam dakord që, në këmbim të këtyre kushteve, të kompensohem me një pagesë shtesë". Pra, referuar këtyre rregullimeve ligjore, të cilat duhet të zbatohen duke filluar nga Janari 2020, paga bruto e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, sa i përket elementit "shtesë për vështirësi pune", mbetet i papërcaktuar nga ligji për sa kohë formulimi i ligjit për kompensim me një pagesë shtesë, nuk tregon masën e pagesës shtesë, pra kjo masë nuk është e përcaktuar apo e përcaktueshme konkretisht, për më tepër që nuk ka ndonjë autoritet që mund ta përcaktojë atë, ndërsa sipas ligjit elementi "shtesë për vështirësi pune" i pagës bruto përcaktohet vetëm nga ligji.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron t'Ju kërkojë ushtrimin me urgjencë të nismës për ndryshime ligjore në Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pikërisht për adresimin e problematikave sensitive në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira në gjykatat e apelit, ato me juridiksion të përgjithshëm dhe ato me juridiksion të posaçëm.

Po ashtu, marrë shkas nga një situatë e krijuar së fundi, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron t'Ju kërkojë ushtrimin e nismës për përmirësime në po të njëtin ligj, Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sikundër edhe në Ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", pikërisht për një çështje të përcaktuar nga ligji nën përgjegjësinë e tij, sikurse është ajo e kryerjes së verifikimit të kushteve dhe kriteve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Konkretisht, duket që formulimi i pikës 6, të nenit 32, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", por edhe ai i pikës 1, të nenit 100, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mund të kenë përbërë shkas për krijimin, në një rast të caktuar, të një shtate, e cila, në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk është në përputhje me frymën dhe qëllimin e ligjit, përveç se cenon veprimtarinë e tij në përmbushje të përgjegjësiave, funksioneve dhe detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji.

Më konkretisht, sipas pikës 6, të nenit 32, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", "Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij".

Ndërsa sipas pikës 1, të nenit 100, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj".

Në këto dispozita nuk përcaktohet qartë se për çfarë mund të bëhet ankimi nga kandidati kundër vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mbetur kështu e paraqartë juridiksioni rishikues i gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.

Ndërkohë, ndryshe nga këto dispozita ligjore, për një proces tjetër me natyrë të njëjtë, pikërisht procesin e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ligji, pikërisht Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1, të nenit 238, ka përcaktuar se “Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar”.

Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, duke përcaktuar se për çfarë mund të bëhet ankimi, vetëm për shkelje të rënda procedurale, ligjvënësi ka përcaktuar dhe juridiksionin e kufizuar (jo të plotë) rishikues të gjykatës.

Po ashtu, ndryshe nga sa përcaktohet në pikën 6, të nenit 32, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për një vendimmarrje tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është i një rëndësie më të pakët në raport me atë sipas nenit 32, ky ligj, në nenin 41, pikat 2 dhe 4, parashikon se “2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë. ... 4. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës”.

Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, duke përcaktuar se vendimmarrja e gjykatës mund të shkojë deri në pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit, i cili, nga ana tjetër, ka detyrimin të rishikojë vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjykatës, ligjvënësi ka përcaktuar dhe juridiksionin e kufizuar (jo të plotë) rishikues të gjykatës.

Në rastin, për shkak të të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron t’ju kërkojë ushtrimin e nismës për përmirësime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” apo dhe në Ligjin nr.155/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”, Gjykata Administrative e Apelit, mbi ankimin e një kandidati për magistrat të diplomuar, jo vetëm ka urdhëruar shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin ishte vendosur skualifikimi i kandidatit për shkak të mos kalimit me sukses të verifikimit të pasurisë dhe refuzimi për emërimin e tij si gjyqtar, por po ashtu, gjykata ka vendosur kualifikimin për emërim të këtij kandidati dhe detyrimin e Këshillit për emërimin e tij. Për momentin, ndërsa ende nuk ka një vendim të arsyetuar të gjykatës, janë të paqarta arsyet për të cilat

gjykata ka arritur në atë vendim të saj, por, përtej atyre, Këshilli i Lartë Gjyqësor është thellësisht i shqetësuar për standardin që gjykata ka pranuar në lidhje me juridiksionin rishikues të saj.

Nga sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor konsideron t'Ju kërkojë ushtrimin me urgjencë të nismës për ndryshime ligjore në Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pikërisht për adresimin e problematikës sensitive në lidhje me juridiksionin rishikues të gjykatës kompetente ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast vlen të konsiderohet edhe plotësimi i ligjit sa i përket përcaktimit të natyrës së vendimit të gjykatës kompetente, pra nëse ai është përfundimtar apo ndaj tij mund të bëhet ankim/rekurs në Gjykatën e Lartë dhe efektet që ai (ankimi/rekursi) shkakton për procesin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor gjen rastin të sjellë në vemendjen Tuaj se disa nga problematikat e parashtruara më lart, i janë bërë prezent, në fomë sugjerimesh për përmirësimin e Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", edhe Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në rastin e draftimit të ndryshimeve të bëra në këtë ligj përmes Ligjit nr.48/2019. Në atë rast, Këshillit iu bë e ditur se objekti i veprimtarisë së Komisionit ishte i kufizuar vetëm në plotësimin e boshllëqeve të krijuara si rezultat i shfuqizimit të dispozitave të caktuara të ligjit nga Gjykata Kushtetuese, por se sugjerimet e Këshillit, sikundër edhe çdo nevojë tjetër, do të merreshin në shqyrtim dhe do të adresoheshin në një kohë shumë të shpejtë.

Duke vlerësuar kontributin dhe angazhimin Tuaj për Reformën në Drejtësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor është besimplotë në ushtrimin nga ana Juaj të nismës për ndryshimet e kërkuara ligjore, ndërsa shpreh angazhimin e tij për të kontribuar në këtë proces përmes dhënies së sugjerimeve apo pjesëmarrjes në takime ekspertësh ose në çdo mënyrë tjetër që Ju do të gjykoni të dobishme.

Me respekt,

KRYETARE



Konceptoi: I.Toska

Pranoi: Anëtarët e KLGJ-së